

Nga Giovanni Armillotta

Kur miq shqiptarë, italianë apo të kombësive të tjera më pyesin nëse jam me origjinë shqiptare apo arbëreshe, përgjigjem gjithnjë jo: paraardhësit e mi ishin gjermanë. Por, në historinë e familjes time unë kam jo një të afërm por një krushk me origjinë shqiptare. Vëllain e të shoqit të kushërirës së nënës sime: Gjeneral Brigadierin Raffaele Castriotta, që edhe nga vetë mbiemri, italianizim i Kastriotit, nënvizon prejardhjen e tij nga Vendi i Shqipeve.

Raffaele Castriotta, lindi në Manfredonia më 14 janar 1887 nga familje e ardhur shqiptare, dhe u shkollua në Seminarin Pontific të Vatikanit. Mbaroi maturën në Gjinnazin e famshëm shtetëror "Ennio Quirino Visconti" të Romës, ndoqi dy kurset e para të filozofisë pranë Institutit të Lartë Pontific të Apollinare-s, fitoi një konkurs pranimi në Akademinë Ushtarake prestigjioze të Modenës dhe në vitin 1910 doli prej aty me gradën nën Toger Këmbësorie. U diplomua në Jurisprudencë dhe në Shkenca Politike e Shoqërore.

**Karriera ushtarake**

Gjatë karrierës së tij të gjatë, mëse 40-vjeçare, fillimisht si Oficer Këmbësorie e më pas si Oficer i Karabinierëve, ka marrë pjesë në Luftën I Botërore, në Luftën e Afrikës dhe në Luftën II Botërore, me guxim, forcë shpirtërore dhe veprimtari të palodhur.

Ka mbuluar detyra të rëndësishme dhe me përgjegjësi, si në zbatimin e shërbimit të Policisë në Romë, Napoli, Torino, Milano, Palermo, ashtu edhe në

Një shqiptar në familjen time**Në kujtim të Gjeneral Brigadierit Raffaele Castriotta**

formimin e ushtarakëve të rinj të pranuar në Armën e Karabinierëve, pranë Shkollës Qendrore të Firences, duke u dalluar për aftësi profesionale dhe edukative.

Oficer Kolonial për plot 23 vjet në Libi dhe në Afrikën Lindore, ka mbuluar detyra të karakterit politik-administrativ në territoret e pushtuara nga Ushtria italiane. Për më tepër, Raffaele Castriotta ka kryer edhe veprimtari diplomatike në Tunizi, Egjipt, Siri dhe Arabi Saudite.

Veprimtaria në jetën qytetare
Me gradën e Gjeneral Brigadierit, gradë që e mori për merita luftarë gjatë konfliktit të fundit botëror, për dy vjet mbajti Komandën e Lartë të Armës së Karabinierëve në Afrikën italiane. Në jetën civile vazhdoi të kryente aktivitetin e palodhur në fushën e organizatave ushtarake, duke u vënë në krye të Shoqatave të Armës dhe atyre luftarake, dhe në provincën e Foggias mori në dorë drejtimin Bashkimit Kombëtar të Oficerëve në Pension. Ka qenë militant i Bashkimit 'Njerëzit e Aksionit Katolik' në dioqezën ee Manfredonias, ku mbuloi edhe detyrën e Presidentit Dioqezan. Gjithnjë ka kryer vepra bamirësie, me ndihma konkrete dhe urtësinë e këshillave, në interes të çdo njeriu dhe të komunitetit. Ka organizuar qarqe argëtuese për të rinjtë; ka ngritur kurse përgatitjeje për persona me pozitë publike dhe kurse kualifikimi për punësime private, si dhe kurse gjuhësh të huaja për të emigruarit. Ka mbajtur për disa vjet Presidencën e Shoqërisë së Kulturës vijon në faqen 22

Një shtëpi pa FASTWEB është si baklavaja pa sherbet.



Falë FASTWEB flet me familjen dhe me miqtë, si në Itali ashtu edhe jashtë saj, pa shumë shpenzime e pa dalë nga shtëpia. E më në fund, mund të telefonosh e të përdorësh internetin pa shkuar në phone center e pa asnjë phone card. Telefono me 40% zbritje të gjithë numrat e rrjetit fiks e të celularëve të Evropës e të Amerikës së Veriut me vetëm 3 euro në muaj, ose të gjithë numrat e botës me vetëm 5 euro në muaj gjithnjë me 40% zbritje. Madje me FASTWEB ke gjithsej 300 minuta të përfshira për t'u lidhur në internet e për të telefonuar të gjithë numrat e rrjetit fiks në Itali. Posta elektronike është falas dhe nuk duhet të paguash kuotën fikse Telecom Italia.

Kurrë më pa telefon fiks. Që sot telefonohet me Fastweb.

Zbulo promocionet e ditës në www.fastweb.it ose telefono në 192.192.

FASTWEB
un passo avanti

Gjeneral Castriotta

vijon nga faqja 21

"Michele Bellucci" të Manfredonias, që e ngritur si Ente morale ka për qëllim ngritjen kulturore ndër studiues.

Shkrimtari

Falë njohjes së thellë që fitoi gjatë viteve të qëndrimit të tij në Afrikë, Gjeneral Brigadieri Raffaele Castriotta, u bë edhe autor i shumë shkrimeve mbi ato troje, duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të shtruara nga Italia për një politikë afrikaniste.

Anëtar i 'Rotary International' të Distriktit të 190 të Italisë, për dy vjet mbuloi detyrën e këshilltarit pranë Klubit të Foggias dhe kultivoi marrëdhënie të ngrohta me miq rotarianë në botë. Për vkatë veprimtari të tijën iu dha titulli i nderit 'Akademik', nga Akademia Ndërkombëtare e Arteve, Shkencave, Letërsisë për Kulturën dhe Progresin Shoqëror, që ndodhet në San Paolo të Brazilit.

Titujt e lartë

Gjeneral Brigadieri Raffaele Castriotta është dekoruar me 4 Medalje Për Zotësi dhe me 6 Kryqe për Merita Luftë; përveç titujve të nderit kalorësiakë italianë, qoftë të monarkisë, qoftë të republikës.

Mes titujve të huaj mund të rendisim: "Urdhri i Skënderbeut"; "Kurora e Belgjikës"; Urdhri Brazilian i Kavalerëve të Kolombit"; "Urdhri Papnor i Shën Gregorit të Madh" (Vatikan); "Legjioni i Nderit" (Franca); "Sol Levante" (Giapone); "Kryqi Gjermanik"; "Kryqi Rumun me Shpata"; "Urdhri i Isabella Katolikes" (Spanja); "Urdhri Ushtarak Sovran i Maltës".

Gjithë këta tituj nderi, civilë apo ushtarakë, dëshmojnë meritat e padiskutueshme të veprimtarisë së gjerë dhe inteligjente të Gjeneral Brigadierit Raffaele Castriotta.

Vdiq 91 vjeç në Manfredonia, më 16 dhjetor 1978, dëshmitar i një vazhdimësie që ka parë shqiptarët mbretër, presidentë, kryeministra, gjeneralë, admiralë, edhe të vendeve të ndryshëm nga ai ku patën origjinë fiset e tyre.

Giovanni Armillotta

nga Lucia NADIN

Fryt paqeje: kështu e komentonte Giovanni Grevembroch imazhin e tregtarëve shqiptarë në Venedik në repertorin e tij të çmuar të jetës dhe zakoneve: *Gli abiti de veneziani di quasi ogni età*, që bëhet edhe më i rëndësishëm meqë është përgatitur në shtatëqindën e vonë, kur jeta në Republikën e Shën Markut shkonte drejt perëndimit. Tregtarët shqiptarë, nënvizonte ai, si "nënshjetas së Shtëpisë së fuqishme otomane" kishin "hyrje dhe vendqëndrim të siguarur në Sinjori". Gjithnjë të pranishëm në qytete për shkak të tregtive të tyre, nuk ngurronin të ndaleshin me dëshirë në Shën Mark "nën fytyrën e fundit të Tempullit" përballë asaj pjese të mozaikut që bënte fjalë për "ceremoni dhe veshje orientale". Edhe prania e tyre ishte Fryt i kësaj peme, me rrenjë shekullore, të politikës venedikase që kish bërë të bashkëjetonin në qytetin tregtar, në qytetin udhëkryq të trafiqeve, gjuhëve, racave, zakone nga më të ndryshmet, duke siguruar një bashkëjetesë paqësore të hebrenjve dhe armenëve, gjermanëve dhe grekëve, dalmatëve dhe persianëve: një bashkëjetesë e ilustruar edhe në një nga kapitelet e Lozhës përdhese të Pallatit dupal, ku "lexohen" akoma edhe sot lidhjet me latinët, tartarët, turqit, grekët, egjiptianët, persët.

Në emërtimin e Grevembroch-ut historia tashmë kishte sedimentuar dhe dekantuar armiqtë dhe urrejtjet për atë "Shtëpi ottomane" që njëherë e njëkohë kishte ridimensionuar në mënyrë përfundimtare rolin e Venedikut në Adriatik dhe Mesdhe. Në figurën në akuarel trajta e shqiptarëve është tipike turke: prej tre shekujsh Shqipëria e kishte humbur rolin e vjetër të "portës së Perëndimit" duke u kthyer në një vend të Lindjes.

Por marrëdhëniet mes venedikasve dhe shqiptarëve dikur kishin qenë të tjera: mes dyqindës dhe treqindës një rrjet i dendur shkëmbimesh tregtare ishte vendosur me qendrat e bregdetit lindor të Adriatikut, në veçanti me ata të zonës së Durrësit, nga ku eksportonin sidomos dru, drithëra e kripë. Një migrim i konsiderueshëm shqiptarësh i ishte drejtuar Venedikut për të ushtruar zanate nga më të ndryshmet, duke u integruar në atë mozaik njerëzish dhe kulturash, që karakterizoi në shekuj kosmopolitizmin e Republikës, e duke i dhënë jetë një komuniteti që do të bashkohet në një shoqëri zyrtare në 1442, fillimisht në Shën Severo, ku ishte ngritur

një manastir kushtuar Shën Galos, i cili bëhet mbrojtësi i tyre i parë, e që do të zhvendoset më pas në kishën emnake të Shën Mauricos, mbrojtësit të dytë të tyre: dy shenjtëve do t'u shtohet Zoja e Këshillit të mirë ose "Zonja jonë e Shkodrës".

Gjatë katërqindës, depërtimi i vazhdueshëm turk në gadishullin ballkanin forcon me kalimin e kohës, - megjithëqë interesat e dyshimta të të dyja palëve -, një aleancë të përbashkët, që, nga njëra anë lidhet me qëndresën njëzetvjeçare përballë sulmeve turke nga Gjergj Kastriot Skënderbeut; e nga ana tjetër, pas vdekjes së tij në 1468, me mbrojtjen e vështirë e me fund të pafat të venedikasve të Shkodrës në dy betejat e famshme të 1474 dhe 1479.

Rënia e Shkodrës do të shënonte hejzën emblematike në fatin e dy popujve: mbyllte për Shqipërinë mundësinë e bashkimit të historisë së saj me atë të Lindjes dhe hapte për Venedikun një përballje - përplasje me Lindjen. Ishte e pashmangshme që ky moment i rëndësishëm i luftës kundër turqve, ishte i destinuar të zhvendosej në horizontin mitik të qytetit

lagunor: në atë të traditës piktorike sidomos, ku prej dorës së Paolo Veronese-s do të pasqyrohen në Pallatin dupal shoqëritë e përbashkëta të shkodoranëve dhe venedikasve; më pas në atë traditë të sigurt historiografike, që, nga Marin Barleti tek Francesco Sansovino e Andrea Morosini-sa për të cituar ndonjë emër-, do t'i kushtojë hapësira të gjera luftës së përbashkët të shqiptarëve dhe venedikasve; dhe në fund në pesëdhjetë e dy letra bixhozi, mes shumë letrave që portretizojnë dozhë dhe zonja të sërës së lartë venedikase, nëntën e bastunëve do t'ua kushtojë Grave të Shkodrës, burrat e të cilave kishin rënë në qëndresën e qytetit. Duke i shoqëruar me emblemën e hermelinit dhe të turtulleshës, simbole respektivisht të pastërtisë së zakoneve dhe besnikërisë morale.

Rënia e Shkodrës shënon edhe një fazë të emigrimit në masë të shqiptarëve në Venedik, të cilëve iu bënë lëshime pa hesap sepse "era iusta e conveniente cossa dar

Janë të shumta materialet që lidhen me historinë e dy popujve në arkivat dhe bibliotekat e qytetit, që presin të studiohen dhe të bëhen të njohura

Djathtas, temë e Gjergj Kastriotit, Venecia, Biblioteca Nazionale Marciana;

